




RAPORT IMPAKTI

2018-2024

ZHVILLIMI PËRMES TRANSPARENCËS DHE ANGAZHIMIT

Qendra e I-rë Rinore e Lezhës:
Praktikojmë Inovacion,
Jetësojmë Parimet e
Autonomisë dhe Gjëmojmë
Ekselencën në Angazhimin
Rinor në Lezhë.

Qendra Rinore H.A.N.A




Tabela e Përmbajtjes

01 ----- Hyrje

02 ----- Rritja përgjatë viteve


03 ----- Programet kryesore dhe arritjet

04 ----- Evolucioni financiar

05 ----- Të dhënat mbi impaktin

06 ----- Mësimet e nxjerra

07 ----- Vizioni i së ardhmes




01 Hyrje

Që në fillimet e saj, H.A.N.A ka qenë më shumë se një organizatë - ajo ka qenë një vepër dashurie, e ndërtuar nga njerëz që besonin në diçka më të madhe se vetja. E lindur nga një vizion për të nisur qendrën e parë rinore në bashkinë e Lezhës, H.A.N.A doli si rezultat i natyrshëm i viteve të kaluara duke punuar drejtpërdrejt me të rinjtë. Me 57 shkolla publike në zonë, duke përfshirë 13 shkolla të mesme dhe 2 shkolla profesionale jo publike, nevoja ishte e qartë: një numri të konsiderueshëm të rinjsh në Lezhë i mungonte jo vetëm hapësira për t'u angazhuar, por edhe mundësia për t'u rritur përmes vlerave- qasje të përqendruara e të rrënjësura në tolerancë, diversitet dhe aktivizëm qytetar. Rinia jonë kishte nevojë për një hapësirë që ti inkurajonte ata të ngrihen kundër padrejtësisë, të kontribuojnë në ndryshime reale dhe t'i zhvillojnë këto ideale nga vetë brenda komunitetit – në vend që kjo të ndodhë përmes institucioneve apo strukturave që shpesh vijnë me axhenda të jashtme ose përmes formave sipërfaqësore të angazhimit. Ky i kuptuar - që të rinjtë e Lezhës dhe Shqipërisë meritojnë hapësira për t'u rritur, ndërlidhur dhe formësuar në jetët e tyre - ka nxitur çdo hap të rrugëtimit tonë. Puna jonë ka qenë gjithmonë e rrënjësuar në besimin se transparenca, integriteti dhe përkushtimi ndaj komunitetit tonë mund të sjellë përparim domethënës, pavarësisht nga pengesat në rrugën tonë.

Rruga që kemi bërë që në ato ditë të hershme ka qenë e mbushur me pengesa, mësim dhe një vendosmëri që erdhi vetëm nga angazhimi ynë për të krijuar diçka kuptimplote. Nuk filluam me të gjitha përgjigjet; në fakt, ne dështuam në përpjekjen tonë të parë për ta themeluar edhe vetë H.A.N.A-n si OJQ/OJF. Ajo paraqitje fillestare në gjykatë, rezultat i përgatitjeve muajsh me avokatë, noterë dhe udhëtime të pafundme në zyrat e gjykatës se Tiranës, na la të prisnim edhe gjashtë muaj të tjerë vetëm për të na u thënë se do të duhej të fillonim nga e para sepse procesi kishte mbaruar afatet ligjore të pritjes për procesim. Pra, ja filluam nga e para - këtë herë, më të vetëdijshëm për barrierat ligjore që ekzistojnë për OJQ-të në Shqipëri. Në pritje të vendimit të gjykatës për kërkesën tonë, ne nuk qëndruam duarkryq. Ne derdhëm energjinë tonë në hartimin e një logoje, ndërtimin e një faqeje interneti dhe ngritjen e një sistemi emaili me .org në fund, sepse donim një qendër të vërtetë, jo vetëm një prani në media sociale.

Kur erdhi koha për të gjetur një hapësirë fizike, ne kërkuam çdo cep të të Lezhës ku reklamoheshin hapësira biznesi me qera, duke vizituar, negociuar dhe vlerësuar opsionet derisa gjetëm vendin e përsosur – pikërisht vendin ku ndodhemi sot. Sipërfaqe e hapur, pa dhoma, 250 m² në katin e dytë të një ndërtese private, e cila përshtatej në mënyrë ideale për vizionin tonë, por që fatmirësisht për ne konsiderohej e papërshtatshëm për qëllime të tjera komerciale për shkak të vendodhjes në hapësirë (kat i 2të).

Çmimi ishte i arsyeshëm, dhe pa u menduar, dakortësuam dhe e morëm me qira. Për dy vjet e kemi paguar qiranë nga xhepat tanë, edhe pse mbulonim njëkohësisht edhe taksat e deklarimet mujore e vjetore sipas ligjit fiskal në vend, si me bashkinë ashtu edhe me



drejtorinë e tatimeve. Mobiljet duhej të prisnin; asokohe, ne mund të përballonim vetëm gjërat thelbësore për të mbajtur H.A.N.A funksionale në fillimet e veta.

Pavarësisht gjithë kësaj, pasioni dhe përkushtimi ynë ishte i diskutueshëm. Ato vite të hershme na mësuam më shumë se çdo trajnim formal për qëndrueshmërinë, këmbënguljen dhe kuptimin e vërtetë të përkushtimit. Sot, H.A.N.A është një dëshmi e këtyre sfidave të kaluara si dhe e besimit se të ndërtosh diçka reale dhe të qëndrueshme për rininë lezhjane ia vlen çdo sakrificë.


Në ato 2 vite të para ('18 - '19), çdo ditë pasi mbaronim punën në organizatën ndërkombëtare ku ishim të punësuar, shkonim drejt e në hapësirën tonë të re, të etur për të derdhur energjitë në diçka që e ndjenim me shpirt si të tonën. Pasditeve, i ftonim të rinjtë vetëm për të folur, për të krijuar njohje, për të cekur ndonjë tematikë ashtu jo-formalisht. Miqtë na huazonin pajisje - një laptop këtu, një projektor atje - që të mund të organizonim pasdite filmash, edhe nëse kjo nënkuptonte që duhej të uleshim në „mobilje“ të improvizuara me zërat tanë që jehonin nga muret bosh të qendres tonë. Ne ishim krenarë për të gjitha, pavarësisht hapësirës së zhveshur; ishte streha jonë dhe ajo po rritej dita-ditës, ndonëse krejtësisht të pavetëdijshëm për përmasat reale që së shpejti do të merrte.

Shtatë muaj në këtë rrugëtim fillestar, pasi aplikonim për çdo mundësi që dilte para, u përballëm me atë që na u duk si një mrekulli - Ambasada e SH.B.A në Shqipëri na dha grantin tonë të parë prej 12,000 dollarësh. Ai projekt ishte "bebja" jonë, një iniciativë e gjitha e ndërtuar prej nesh e mbushur përplot me ambiciet naive të ditëve tona më të hershme në këtë rrugëtim.

Lundruam në një det sfidash, shpesh të keqkuptuar në qëllimet tona, dhe me raste duke na u mohuar padrejtësisht mundi dhe mbështetja, pavarësisht përpjekjeve tona vetë-mohuese. Me atë grant të parë, ne arritëm të ndërtonim një ndërhyrje të strukturuar, e para e atij lloji me mbështetje të jashtme që mundi të angazhojë drejtpërdrejt mbi 50 të rinj si dhe mbledhi së bashku rreth 150 anëtarë të komunitetit tonë në Lezhë përmes konferencave dhe forumeve tona të para. Në kanalën tonë të YouTube, kemi copëza zbatimi nga ato kohëra.

Nuk ishte gjithmonë e lehtë, por ato momente, duke u ulur me të rinjtë tanë në ato karriget e huazuara, duke ndërtuar diçka nga asgjëja, është në fakt themeli i gjithçkaje që H.A.N.A përfaqëson sot. Të ndërgjegjshëm që nuk krijuam thjesht një qendër rinore – po krijuam avash avash një komunitet të vogël dhe kjo është diçka që e ruajmë fort në zemër edhe sot si motivimin më të madh.

Më pas erdhi një mundësi që ne as që e dinim që na nevojitej si ajri që thithnim në misionin që kishim ndërmarrë —një mundësi që do të ndryshonte gjithçka për H.A.N.A-n tonë. Asokohe, ne nuk e kuptonim plotësisht konceptin e mbështetjes bazë (core support), por




shumë shpejt kuptuam se sa vendimtare ishte. EED (European Endowment for Democracy), një agjenci e themeluar nga BE, jo prej shumë kohësh, dërgoi dikë për t'u takuar krejt rastësishëm me ne, një konsulent kombëtar që udhëtonte në të gjithë Shqipërinë për t'u lidhur me njerëzit që punojnë për të avancuar demokracinë në komunitetet e tyre lokale. Ishte një takim krejt jo formal, një bisedë pa pritshmëri. Por jo shumë kohë më vonë, për habinë tonë të plotë, ne u ftuam të paraqisnim një projekt-propozim për ta kthyer H.A.N.A'n në një qender plotësisht funksionale e të mirëpajisur për të shërbyer të rinjve Lezhjanë e më gjerë.

Kur dëgjuam se EED na kishte akorduar 80,000 € për të ngritur dhe pajisur qendrën tonë rinore në Lezhë, ishte një moment përtej aftësisë tonë për ta përshkruar me fjalë në këtë hyrje. Ata kishin edhe një kusht: duhej t'i përkustoheshim tërësisht kësaj përvoje të re, që do të thotë se do të duhej të linim pas punët tona të mëparshme. Kjo shkaktoi disa dilema brenda nesh, por përfaqësuesja ligjore, pa hezitime dhe e vetëdijshme se nga rrugëtimi i mëparshëm profesional kishte marrë tanimë më të mirën, e hodhi atë hap me entuziazmin e emocionet e një të ardhmeje befauese, ashtu siç fillimet kishin qënë. Ndonëse, brenda nesh, ezksitonin edhe disa pasiguri se çfarë do të ndodhte sapo të përfundonte mbështetja në fjalë, aq më tepër që një pandemi globale tronditi botët tona duke na ri-dimensionuar përgjithmonë perceptimet ekzistuese për realitetin (2020-2022). Por emocioni dhe besimi në këtë realitet të ri ishin më të forta se dyshimet dhe frikërat.

Ne u „zhytëm“ tërësisht në modelimin e hapësirës që kishim ëndërruar kaq gjatë. Me burime të kufizuara, filluam të dekorojmë dhomat boshe me projekte artizanati duke i shndërruar këndet në hapësira kreative, të hapura me ndarje të dedikuara për aktivitete/shërbime të ndryshme. Ky ishte veçse fillimi i rrugëtimit tonë drejt konsolidimit – një fazë e re të mësuarit, rritjeje dhe transformimi. Nga ai moment, H.A.N.A nuk ishte më thjesht një vizion i largët në mëndjet tona, por një realitet i plotë, i rrënjësor në zemër të Lezhës.

Ndërsa udhëtimi ynë përparonte, vizioni po ashtu filloi të merrte trajta. Kuptuam se pavarësisht se kishim pasionin, entuziazmin dhe përkushtimin, ajo që do të na bënte edhe më të fortë ishte ndërtimi i një rrjeti – ndërlidhja me individë dhe organizata që, si ne, ishin të përkushtuar për të krijuar ndryshime të dukshme e të ndjeshme në komunitetet e tyre. EED nuk siguroi vetëm financim për ne; na bëri pjesë të një rrjeti njerëzish frymëzues, të gjithë që bënë një punë të jashtëzakonshme me etikë, disiplinë dhe përkushtim ndaj kauzave të tyre. Nëpërmjet këtij rrjeti, ne po kuptonim ngadalë se çfarë ishte e mundur dhe filluam kështu të kapërcejmë kufijtë e mentalitetit që shpesh na kishte vënë para një tis mjegulle e barrierash që na limitonon në komunitetin tonë të vogël por me mendësi të paracaktuara.

Në një vend si Lezha, ku bindja se organizatat ekzistojnë vetëm për përfitime apo njohje e afirmime personale është e ngulitur thellë, sfidimi i këtij mentaliteti të mbyllur nuk ishte i lehtë.




Ne e dinim që H.A.N.A nuk ishte konceptuar kurrë të ishte një organizatë me një person dhe as nuk kishte të bënte me avancimin e rritjes personale të atyre që ishin të përfshirë. Në vend të kësaj, qëllimi ynë ishte dhe mbetet t'i shërbejmë komunitetit tonë dhe të nxisim shkëndija për ndryshim të vërtetë, ndonëse ende të paqartë për mënyrat se si arrihet në këtë qëllim të madh sa vetë jeta. E sigurisht që kur nisësh të sfidosh status quo-në e një komuniteti të vogël, ku varësia nga institucionet publike dhe ndikimet politike formësonte perceptimet e botëkuptimit, më e pakta, ti përballësh me rezistencë. Fillimisht, pati nga ata që na etiketuan si të pasinqertë ose na akuzuan për axhenda të fshehura. Por ndërsa u ndërlidhëm me të tjerë përtej këtyre kufizimeve lokale, filluam të shihnim vlerën e vërtetë të punës sonë.

Vetëm kur shkëputesh nga kufizimet e një vendi me stile të menduari, jetuari e vepruari tepër të ngurta e të rrënjësura e jashtë mase refuzues ndaj të ndryshmes apo ndryshimit, arrin të kuptosh rëndësinë e misionit tënd. Akumulimi i viteve përvojë, ekspozimi ndaj modeleve të pafundme (kaluar 1 dekadë përvojë paraprake) të progresit shoqëror e zhvillimit personal e profesional, nuk mund të zhbëheshin sepse tanimë papritmas u riktheve në zemër të realitetit të komunitetit tënd të vogël. E megjithatë, koha është mësuesja më e mirë dhe tregimtarja më e vërtetë dhe ajo foli; angazhimi i H.A.N.A-s rezultoi i palëkundur. Tashmë e dimë se puna jonë duhet të vazhdojë, jo vetëm për të rinjtë e Lezhës, por si dëshmi e fuqisë transformuese të përkushtimit të vërtetë ndaj progresit shoqëror.

Sot, ndërsa prezantojmë raportin tonë të parë të impaktit (ndikimit), hedhim sytë prapa në udhëtimin që e përjetuam në lëkurë dhe na është dukur sa i stërgjatë aq dhe momental e i shkurtër.

Me kalimin e viteve, ne e kemi prezantuar punën tonë në mënyra të ndryshme para jush, përmes publikimit e bashkëndarjes së ndërhyrjeve të ndryshme që kemi zbatuar, e megjithatë, reflektimi mbi çdo hap të kaluar na risjell një ndjesi të përtërirë qëllimi dhe krenarie. H.A.N.A është formësuar nga njerëzit që kanë ardhur dhe ikur—anëtarët e ekipit, brezat e të rinjve, partnerët dhe mbështetësit—secili duke lënë një shenjë unike. Së bashku, ne u rritëm pa një formulë të ngurtë, të udhëhequr në vend të kësaj nga një vizion i palëkundur: për të ndezur një frymë përkushtimi ndaj të mirës së përbashkët, qoftë në nivel lokal apo kombëtar, si dhe për të gjëmuar kurdoherë përsosmërinë dhe rritjen, asnjehërë regresin e hapat pas.

Qindra të rinj vizitojnë qendrën tonë çdo vit dhe iniciativat tona kanë ndikuar në forma të ndryshme mijëra anëtarë të komunitetit, palë të interesuara, partnerë dhe frekuentues të rastësishëm. H.A.N.A ka mirëpritur me krenari ambasadorë të vendeve të BE-së, përfaqësues nga qeveria shqiptare, përfshirë kryetarin e bashkisë dhe ministra, apo edhe delegatë nga agjencitë e OKB-së, OSBE-së dhe shumë të tjerë. Ne kemi organizuar mesatarisht 90 aktivitete dhe ngjarje publike çdo vit, duke u kthyer në një prani të pashmangshme e me ndikim në Lezhë. Me 21 projekte të zbatuara me sukses deri më sot dhe me një ekip të përkushtuar full-



time (40 orë në javë) prej katër vetash, trashëgimia e H.A.N.A-s është ajo për të cilën jemi thellësisht krenarë, një dëshmi e asaj që mund të arrihet prej këmbënguljes dhe vizionit të përbashkët për një mjedis më të denjë përreth nesh.


02 Rritja ndër vite (2018 - 2023)

➡ 2018 - 2019: Themelet dhe hapat e parë

Që nga themelimi i saj, H.A.N.A ka nisur një udhëtim transformues, duke u rritur nga një nismë e vogël e drejtuar nga disa pjesëtar të komunitetit Lezhjan, në një qendër rinore të njohur e konsoliduar, e cila ndikon qindra të rinj dhe anëtarë të komunitetit çdo vit. Kjo rritje është shënuar nga përkushtimi, adaptueshmëria dhe angazhimi për të trajtuar çështje të rëndësishme në Lezhë dhe më gjerë. Më poshtë është një pasqyrë vjetore e progresit të H.A.N.A dhe momenteve kyçe që formësuan rrugëtimin e saj.

Entuziazmi ynë i paepur ishte ajo që ngriti dhe mbajti H.A.N.A në këmbë në ditët e saj të para. Duke jetuar në Lezhë, e ndjemë për së afërmi boshllëkun e konsiderueshëm që shkaktonte mungesa e hapësirave të dedikuara për të rinjtë, një boshllëk që dukej se rritej me kalimin e çdo viti. Përpara se të themelonim H.A.N.A, ne ishim të përfshirë aktivisht në advokim me një grup të rinjsh Lezhjanë pranë bashkisë, duke kërkuar nga autoritetet vendore krijimin e një qendre rinore, siç e përshkruan ligji në nivel qarku. Por, pavarësisht kërkesave tona, përgjigja ishte ngurrimi dhe mosveprimi. Të frustruar, por të vendosur, vendosëm ta marrim situatën në dorën tonë: "Nëse ata nuk duan apo nuk shohin vlerë në krijimin e një hapësirë për të rinjtë, ne do ta bëjmë vetë." Dhe me këtë vendosmëri, ndërmorëm idenë e guximshme të krijimit të një qendre rinore sipas stilit "bëjë-vetë" apo në formë artizanale, të drejtuar nga bindja se edhe një përjekje e vogël mund të rritej në diçka të fuqishme për komunitetin tonë.

Për gati një vit para se H.A.N.A të ekzistonte zyrtarisht, investuam kohë, burime dhe vendosmëri për të sjellë në jetë vizionin tonë për një OJF/OJQ rinore. Ideja mori formë në mendje dhe letër dhe aty nga mesi i vitit 2017 u paraqitem tek një noter lokal, hartuam aktin themeltar dhe statutin dhe kontraktuam një avokat për të dorëzuar dokumentet në gjykatë. Na u deshën gjashtë muaj shkëmbimesh e ecejakesh, me gjykatën që identifikonte vazhdimisht gabime që as avokati e as noteri ynë nuk i kishin vënë re. Kur rregulluam çështjen e fundit, afati ligjor prej gjashtë muajsh kishte skaduar dhe na duhej të fillonim nga e para. Pa u dekurajuar, kontraktuam një avokat tjetër dhe bashkëpunuam me një noter në Tiranë në Janar të vitit 2018. Pas tre muajsh, më në fund morëm vendimin e gjykatës, që




konfirmonte statusin tonë si OJF/OJQ themeluar me vendim gjykate Nr. 1243, date 21 Mars, 2018. Ishte një moment emocionues për ne. Donim që gjithçka të bëhej si duhet, ndaj menjëherë u regjistruam në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve në Lezhë për të marrë NIPT-in dhe më pas proceduam në hapjen e një llogarie bankare—një proces i lodhshëm, duke qenë se kuptuam që përvec shtetit e gjykatave, edhe sektori bankar për OJF/OJQ-të ka kontrole të ashpra, në gjykimin tone jo gjithmonë të arsyeshme, ndërkohë që edhe bizneset hasin më pak barriera.

Me statusin dhe identitetin ligjor të konfirmuar tanimë, filluam të kërkonim vendndodhjen e duhur, duke bredhur gjithandej në Lezhë për të eksploruar çdo hapësirë të mundshme me qira, derisa gjetëm një që na përshtatej. E siguruam dhe ajo hapësirë u bë e jona, edhe pse fillimisht kishim vetëm karrige të huazuara dhe mobilje të improvizuara. Për të krijuar një bazë të mire dhe presence dinjitoze, ne kontraktuam një specialist IT-je për të na ardhur në ndihmë në dizejnimin e logos, që do të shkonte në vulën organizative gjithashtu si dhe ndërtimin nga e para të një faqeje interneti. Shumë orë u investuan për të gjetur, hartuar e përpunuar përmbajtjen perfekte për praninë tonë online. Pas punës së përditshme, kalonim pasdite dhe fundjava duke organizuar mbledhje jo-formale, për të testuar interesat dhe nevojat e të rinjve. Huazonim karrige dhe mjete të tjera nga shkollat dhe bashkia për të bërë më mikpritëse hapësirën tonë. Ishte një përpjekje e madhe dhe vepër dashurie, një përkushtim i verbër dhe një vizion për të krijuar diçka domethënëse për të rinjtë e Lezhës dhe për veten tonë si kontribut vetjak ndaj shoqërisë pjesë e së cilës ishim.

Ndërhyrjet e para të strukturuar të financuara nga donatorët

Mbështetja nga Ambasada e SHBA ka një vend të veçantë në zemrat tona. Ata ishin të parët që panë potencial në ëndrrën tonë, të parët që besuan se vizioni ynë për të rinjtë në Lezhë ia vlente të investohej. Marrja e atij granti fillestar ishte më shumë se thjesht një mbështetje financiare—ishte një konfirmim i fuqishëm se ishim në rrugën e duhur, se përpjekjet tona po shiheshin dhe vlerësoheshin. Kjo mbështetje na dha kurajon për të ëndërruar edhe për më shumë, duke na zbardhur një horizont të ri përpara. Mbështetja nuk na ndihmoi thjesht të fillonim; ajo na dha besimin për të kapërcyer dyshimet dhe sfidat, duke ditur se kishim partnerë që bashkëndanin angazhimin tonë për të krijuar ndryshim real në Lezhë. Në shumë mënyra, kjo mbështetje ishte një gur themeli për gjithçka që pasoi, duke na bërë pjesë të një udhëtimi të karakterizuar nga këmbëngulja, zhvillimi dhe një përkushtim të rinovuar ndaj komunitetit tonë.

Dy grantet e para shënuan momente themelore në udhëtimin e H.A.N.A, duke na siguruar burimet dhe njohjen e jashtme të nevojshme për të përforcuar pozitat tona në komunitetin e Lezhës. Mbështetja fillestare nga Ambasada e SH.B.A na mundësoi të startonim iniciativën Y.E.S (Young, Eager & Successful) – A Call for Action, e cila na lejoi të angazhohim të rinjtë aty




afër nesh në mënyra të reja. Iniciativa Y.E.S synoi të trajtonte problemin e largimit të trurit (Brain Drain) duke formësuar identitetin e të rinjve, duke inkurajuar rritjen profesionale dhe duke krijuar një mjedis ku të rinjtë mund të shihnin mundësi të ardhshme brenda Shqipërisë. Përmes punëtorive, forumeve dhe një platforme dixhitale, kontribuam në mënyra se si ata (të rinjtë e përfshirë) të mund ta vizualizonin të ardhmen e tyre në vend, duke krijuar një bazë pjesëmarrësish të motivuar dhe duke nxitur bashkëpunimin me institucionet në Lezhë.

Më shumë se 50 të rinj u angazhuan drejtpërdrejtë në seanca trajnimi të fokusuara në zhvillimin personal dhe profesional, me tema si komunikimi, përmirësimi i vetes dhe përdorimi efikas i mjeteve online. Përmes këtyre punëtorive, të rinjtë fituan aftësi të rëndësishme si përgatitja e CV-ve, shkrimi i letrave motivuese dhe planifikimi i karrierës. Një moment i rëndësishëm ishte krijimi i "Platforma Rinore YES", një burim online që lidhte të rinjtë (fatkeqësisht nuk mundëm ta përballonim mirëmbajtjen e saj 2 vite pas përfundimit të projektit) me mundësi pune, praktikash dhe burime për zhvillim aftësish. Kjo platformë ofroi një hapësirë të nevojshme virtuale për të rinjtë për të eksploruar mundësitë e zhvillimit akademik, profesional dhe personal, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme për të rinjtë e Lezhës.

Projekti organizoi forume komunitare, punëtori dhe aktivitete publike, duke nxitur dialogun mbi çështje të rëndësishme si punësimi i të rinjve dhe emigracioni. Këto aktivitete përshinin folës figura publike në Lezhë dhe jashtë saj, të cilët inkurajuan pjesëmarrësit e rinj të investonin në komunitetet e tyre dhe të konsideronin mundësitë brenda Shqipërisë. Projekti krijoi partneritete me biznese lokale, drejtues të bashkisë dhe institucione arsimore, duke krijuar një rrjet mbështetës për punësimin dhe zhvillimin e aftësive të të rinjve. Ky bashkëpunim çoi në mbështetjen e iniciativave si praktikat e paguara në institucionet publike lokale, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt fuqizimit të të rinjve dhe mbështetjes institucionale në Lezhë.

Pak më pas, nga mesi I vitit 2019, bashkëpunimi ynë me SCPA (Programi "Strengthening Community Policing in Albania", i prezencës Suedeze në Shqipëri) na mundësoi të trajtonim një nevojë të ngutshme të komunitetit për ndërgjegjësimin mbi dhunën në familje. Kjo iniciativë bashkoi Policinë e Lezhës, Shërbimet Sociale Shtetërore, 6 Shkolla Publike dhe të rinjtë, pjesë e tyre, për të nxitur dialogun dhe kuptimin e ligjit të rishikuar të Shqipërisë për dhunën në familje. Përmes diskutimeve në tryeza të rrumbullakëta, punëve multimediale dhe videove të drejtuara nga të rinjtë, ne ofruam një platformë për biseda të hapura dhe lehtësuam për lidhje më të forta midis anëtarëve të komunitetit dhe organeve të rendit. Ky projekt ishte një pikë kthese, duke treguar aftësinë tonë për të trajtuar çështje të thella dhe duke forcuar kapacitetin tonë për të trajtuar tema të ndjeshme me ndikim domethënës. Falë tij, do të profilizoheshim, ndër të tjera, edhe në fushën e edukimit gjinor.




Në kuadrin e programit të Forcimit të Policimit në Komunitet në Shqipëri, financuar nga prania suedeze në Shqipëri, iniciativa jonë "Shoqërizimi i Ligjit të Rishikuar për Dhunën në Familje" u shfaq ndërsa ishim ende në fazat e hershme të zbatimit të iniciativës së parë të mbështetur nga Ambasada e SHBA. Kjo iniciativë synonte të ngushtonte hendekun midis organeve të rendit dhe komunitetit tonë, duke nxitur një kuptim të ndërthurur mbi ligjin e rishikuar të dhunës në familje në Shqipëri. Kjo iniciativë, që përqendrohej si në Lezhë, ashtu edhe në Rrëshen, synonte jo vetëm të informonte, por të krijonte një hapësirë bashkëpunuese ku anëtarët e komunitetit të mund të angazhoheshin drejtpërdrejtë me autoritetet lokale, duke fituar një kuptim më të thellë të rolit të tyre në parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës në familje.

Në të dyja zonat, Lezhë dhe Rrëshen, organizuam forume komunitare që bashkuan përfaqësuesit e policisë, institucionet lokale, prindër, të rinjtë dhe shoqërinë civile. Këto dialogje ofruan një hapësirë për biseda të hapura, duke lejuar komunitetin të kuptonte se si organet e rendit i trajtojnë rastet e dhunës në familje dhe duke u dhënë oficerëve të Policimit në Komunitet një platformë për të ndarë kompleksitetet dhe përgjegjësitë që lidhen me zbatimin e ligjit. Ky shkëmbim perspektivash ishte një hap i rëndësishëm drejt ndërtesës së besimit dhe vendosjes së një ndjenje të përbashkët për përgjegjësi.

Puna jonë u shtri më tej përmes angazhimit multimedial. Duke bashkëpunuar me 45 të rinj nga Balldreni i Lezhës, prodhuam dy video që synonin të thjeshtonin ligjin e rishikuar, duke e bërë mbrojtjen e tij të qasshme dhe të rëndësishme, veçanërisht për të rinjtë. Këto video shërbyen si mjete edukative dhe frymëzuan të rinjtë të angazhohen më shumë me çështje që ndikojnë drejtpërdrejtë komunitetin e tyre. Duke pasur në vëmendje zërat dhe perspektivat e të rinjve lokalë, videot ndihmuan në krijimin e një ndjenje fuqizimi dhe lidhjeje me iniciativën.

Si pjesë e këtij projekti, zhvilluam gjashtë sesione informuese të fokusuara me nxënës të shkollave të mesme të moshës 15-18 vjeç në Lezhë. Këto sesione theksuan rëndësinë e njohjes së shenjave të dhunës në lidhje intime dhe familje dhe nënvizuan rolin mbështetës të policimit në komunitet. Pas këtyre sesioneve, pjesëmarrësit plotësuan pyetësorë, dhe të dhënat u përdorën për të përpiluar një raport analize të publikuar, "Perceptimet dhe Qëndrimet e të Rinjve Lidhur me Dhunën me Bazë Gjinore", që tani është i aksesueshëm në faqen tonë të internetit, publikimi ynë i parë. Ky raport ofron një pamje të thellë mbi perceptimet dhe qëndrimet e të rinjve ndaj dhunës me bazë gjinore, duke ofruar të dhëna të vlefshme që do të udhëhiqnin përpjekjet tona të ardhshme për ndërgjegjësim dhe parandalim.

Përmes "Shoqërizimi i Ligjit të Rishikuar për Dhunën në Familje", ne vumë re një përforsim të raporteve midis komunitetit dhe organeve të rendit lokal duke qënë se Policimi në Komunitet sa po prezantohej e promovohet si qasje në nivel kombëtar. Kjo iniciativë jo vetëm



ngriti ndërgjegjësimin, por gjithashtu ndikoi në një angazhim të shtuar për sigurinë e komunitetit, duke fuqizuar të rinjtë dhe të rriturit që të marrin pjesë aktive në parandalimin dhe kuptimin e dhunës në familje në mënyra proaktive.

Në vitet tona të para pas themelimit, 2018-2019, angazhuam drejtpërdrejtë 47 të rinj dhe indirect më shumë se 150 anëtarë të komunitetit, në fushën e aftësive për zhvillimin profesional dhe angazhimin lokal. Ndërkohë, përmes ndërhyrjes dhe ndërgjegjësimit mbi ligjin e dhunës në familje, përshimë 261 individë, duke përmirësuar të kuptuarit e komunitetit dhe duke forcuar besimin me organet lokale të rendit.


Këto përpjekje për të angazhuar dhe për të arritur 458 të rinj dhe anëtarë të gjerë të komunitetit në dy vitet tona të para, krijuan një bazë të fortë të fuqizimit të të rinjve dhe besimit në komunitet, duke vendosur skenën për ndikimin e vazhdueshëm të H.A.N.A në Lezhë.

2020: Fuqizimi përmes mbështetjes thelbësore/programatike

Tre muajt e parë të vitit, pas marrëveshjes sonë me EED, e cila na dha 80,000 euro mbështetje për të nisur qendrën tonë rinore, u shënjuan nga ekzaltimi dhe kreativiteti pakufi. Me vizionin më në fund në prag të realizimit, kaluam orë të panumërta duke projektuar planin në mendje dhe pastaj duke i përkthyer këto ide në letër, duke skicuar çdo detaj për të krijuar një imazh të qartë për produktin final se si do dukej qendra jonë. Qendra duhej të perceptohej nga të gjithë si një hapësirë e lirë dhe mikpritëse, me kënde të ndara jo nga muret, por nga rafte librash, duke nxitur ndjesinë e afërsisë me ambientin. Përqafuam frymën "Bëje Vetë", të vendosur për ta formësuar qendrën tonë me duart tona. Lëndet e para si dërrasa dhe shufra hekuri u bënë thelbësore për krijimin rafteve/ndarjeve për libra që kishim imagjinuar, duke i dhënë çdo pjesë të qendrës një imazh ngrohtësie dhe afriteti.

Kërkimi për pajisje për qendrën tonë na çoi në gjithë Shqipërinë, teksa siguroam kompjuterë, printera, kamera, projektorë, sisteme audio, tavolina, karrige dhe të gjitha të domosdoshmet për një kuzhinë të vogël—çdo send u zgjodh me kujdes për të krijuar një hapësirë që do ti shërbente rinisë në çdo mënyrë të mundshme. Ky proces nuk ishte thjesht mobilim i një ndërtesë; ishte ngritja e themeleve të një ëndrre, një që së shpejti do të bëhej realitet si hapësira e parë e dedikuar të rinjve në Lezhë.

Në vitin 2020, H.A.N.A u zhvillua nga një hapësirë e thjeshtë takimesh në një qendër të plotë funksionale rinore, duke lançuar gjashtë kënde të specializuara shërbimi që përfshinin një hapësirë multimediale, punëtori për riciklim kreativ, një kënd social dhe një mini-muze dedikuar viktimave të totalitarizmit në Shqipëri. H.A.N.A u hap zyrtarisht në Qershor 2020, duke shënuar një moment të rëndësishëm për organizatën. Ky event ishte i veçantë jo vetëm për themelimin e saj si qendër rinore, por sepse përfaqësonte kulmin e shumë muajve



planifikim dhe punë të palodhur. Hapja e madhe mbledhi 33 pjesëmarrës, duke qënë në pikun e pandemisë ku mbledhjet nuk lejoheshin, si dhe duke simbolizuar mbështetjen dhe entuziazmin e komunitetit për qendrën.


Gjithashtu, një fushatë pastrimi në Lagunën e Kune-Vainit më 26 qershor angazhoi mbi 30 pjesëmarrës, duke treguar shembuj të hershëm të angazhimit të H.A.N.A në nisma mjedisore dhe të orientuara drejt komunitetit.

Pavarësisht sfidave të sjella nga pandemia COVID-19, H.A.N.A arriti të organizonte 63 aktivitete që angazhuan drejtpërdrejt mbi 100 të rinj (143), duke mbuluar një gamë të larmishme temash—nga aftësitë për tregimtari multimediale te ndërgjegjësimi mjedisor dhe aktivizmi qytetar—duke krijuar përvoja të vlefshme të të nxëniet që të rinjtë mund të marrin me vete në të ardhmen. Ky vit shënoi zgjerimin e arritjeve tona, me aktivitete të nisura në bashkëpunim me partnerë të rinj lokalë, duke përfshirë shkolla të mesme dhe përfaqësues të bashkisë. Në fillim të vitit 2020, H.A.N.A prezantoi zyrtarisht qendrën rinore si një hapësirë aktive, duke ofruar një varietet punëtorish, diskutimesh dhe seancash trajnimi për rritjen profesionale dhe personale.

Partneritete me institucione të njohura, si Lezha Academic Centre, Bashkia Lezhë dhe biznese të ndryshme lokale, mbështetën nismat tona duke ofruar burime praktike dhe hapësira për mbledhje më të mëdha dhe diskutime mbi tema të rëndësishme për të rinjtë si planifikimi i karrierës dhe angazhimi në komunitet. Partneriteti me Caritas Dioqezan Lezhë në Maj 2020 ishte veçanërisht me ndikim për H.A.N.A, pasi i mundësoi qendrës të shtonte një praktikante në ekip, duke rritur kapacitetin tonë për të shërbyer komunitetin rinor në Lezhë. Ky partneritet shënoi një hap përpara në ndërtesën e një rrjeti mbështetës rreth H.A.N.A, duke forcuar angazhimin tonë për zhvillim profesional dhe fuqizim të të rinjve brenda komunitetit. Përmes këtij bashkëpunimi, H.A.N.A mundi të zgjerojë shërbimet e saj duke ofruar edhe mundësi të prekshme për të rinjtë që kërkojnë përvojë praktike dhe angazhim në shoqërinë civile.

Përveç programeve tona kryesore, klubi "Bëhu Burrë" u nis në bashkëpunim me Act for Society, të cilët kontaktuan për të bashkëpunuar në krijimin e klubeve rinore në Lezhë si pjesë e iniciativës së tyre më të gjerë. Ky project zbatohet në kuadër të një ndërhyrjeje më të madhe zbatuar nga një konsorcium i udhëhequr nga Care International me financim nga OKB dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA). Klubi angazhoi 38 vajza dhe djem në diskutime rreth maskulinitetit pozitiv, duke sfiduar stereotipet tradicionale dhe duke promovuar barazinë gjinore. Ky bashkëpunim i mundësoi H.A.N.A të zgjerojë arritjet e saj brenda komunitetit, duke ofruar një hapësirë të dedikuar për djemtë e rinj për të reflektuar mbi rolet gjinore dhe duke nxitur një komunitet rinor më të përfshirë dhe të ndërgjegjësuar në Lezhë.

Në vitin 2020, ndërsa H.A.N.A përforcoi rolin e saj si një partner lokal, u mundësua një bashkëpunim kyç me gjimnazin publik "Hydajet Lezha" për të lehtësuar orët e shërbimit



komunitar për nxënësit e shkollave të mesme. 76 nxënës nga ky institucion morën pjesë në aktivitete të ndryshme në qendër, duke kontribuar aktivisht në nisma që synonin të përforconin angazhimin komunitar dhe përgjegjësinë shoqërore. Ky bashkëpunim i lejoi nxënësit të angazhoheshin në projekte praktike që promovonin përgjegjësinë qytetare dhe u jepte atyre ndjenjën e kontributit brenda komunitetit të tyre.

Së fundmi, u prodhuan edhe katër video-dokumentarë me mesazhe të forta mbi dhunën me bazë gjinore, që e zgjeruan mesazhin tonë për një audiencë më të gjerë përmes kanaleve dixhitale. Secila nga këto nisma theksoi adaptueshmërinë e H.A.N.A dhe angazhimin për të mbetur një prani konsistente dhe transformuese për të rinjtë, duke forcuar themelet tona dhe zgjeruar arritjet tona edhe përballë sfidave të paprecedenta globale.


Në total, viti 2020 u përmbyll me një bilanc që numëronte 63 aktivitete, dhe angazhimin e 143 pjesëmarrësve në një varietet nismash edukative me pjesëmarrje lokale. Ky vit shënoi një periudhë kyçe në zhvillimin tonë, teksa ne u përshtatëm ndaj sfidave, zgjeruam njohjet tona dhe fuqizuam rolin tonë si një qendër rinore e besuar në Lezhë. Këto përpjekje vunë në pah angazhimin e H.A.N.A për të kultivuar një komunitet rinor të aftë dhe të fuqizuar, si dhe të dedikuar për ndryshime pozitive shoqërore.

2021: Zgjerimi i shtrirjes dhe qëndrueshmërisë në mes të pandemisë

Viti 2021 ishte një periudhë transformuese për Qendrën H.A.N.A., pasi ja arriti të vendosë një imazh si një qendër dinamike rinore në Lezhë. Gjatë vitit, organizata u përqendrua në tre fusha strategjike: edukimin mediatik, edukimin mjedisor, barazinë gjinore dhe angazhimin e të rinjve në çështje politike dhe shoqërore.

Gjithashtu, disa nga nismat e reja të prezantuara në vitin 2021 ishin më intensive krahasuar me vitet e mëparshme, duke kërkuar përkushtim të përqendruar nga një ekip i vogël. Pavarësisht këtyre sfidave, H.A.N.A arriti të zhvillonte partneritete të reja, të niste projekte me ndikim dhe të sigurojë pjesëmarrje të vazhdueshme të të rinjve, duke forcuar rolin e saj si një aktor kyç në shoqërinë civile të Lezhës, duke promovuar angazhimin qytetar dhe duke adresuar sfidat e komunitetit.

Në fillim të vitit, H.A.N.A nisi një rrugëtim të ri me rëndësi të jashtëzakonshme, partneriteti me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Dukatit të Madh të Luksemburgut. Ky bashkëpunim filloi në fund të vitit 2020, kur H.A.N.A's ju besua misioni i avancimit të demokratizimit, sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut dhe kontributit direkt në procesin e integritetit në Bashkimin Evropian përmes angazhimit të të rinjve. Qendra dizenjoi një program ambicioz tre-mujor për të prezantuar pjesëmarrësit e rinj me disa njohuri politike si dhe me udhëtimin e integritetit të Shqipërisë në BE. Kjo nismë synonte jo vetëm të edukonte të rinjtë mbi kuptimin e vërtetë të procesve të hartimit të politikave, por gjithashtu të thyente




asociimet negative të "politikës së keqe" që shpesh i pengon të rinjtë të angazhohen në skenën politike të Shqipërisë. Duke ofruar një të kuptuar më të gjerë të politikës dhe demokracisë përfaqësuese, programi synonte të frymëzonte pjesëmarrësit e rinj që të bëheshin kontributorë të ardhshëm në hartimin e politikave por edhe udhëheqës proaktivë qytetarë.

Kurrikula për shkollën dimërore nuk ishte paraprakisht ekzistuese, por u zhvillua me mbështetjen e ekspertëve të fushës si dhe bashkëpunëtorëve, specifikisht për të përmbushur nevojat e të rinjve të moshës 17-19 vjeç. Vetëm brenda tre javësh, H.A.N.A finalizoi një kurrikulë gjithëpërfshirëse që mbulonte tema të rëndësishme, duke ofruar një përvojë tërheqëse dhe pasuruese të të nxënës. Rekrutimi i të rinjve për programin u krye përmes një marrëveshjeje me shkollën jo-publike të Lezhës "Lezha Academic Center" dhe u plotësua me të rinj të tjerë që u rekrutuan nga komunikimet e mëtejshme në rrjete sociale dhe takime të drejtpërdrejta prezantimi me programin. Si rezultat i këtyre përpjekjeve, shkolla dimërore tërhoqi një grup të larmishëm prej 31 pjesëmarrësish, të moshës 16 deri 31 vjeç, shumë më shumë se synimi fillestar prej 15-20 të rinjsh.

Kjo nismë ishte një nga përvojat dhe ndërhyrjet më të rëndësishme të zbatuara brenda programit të qendrës rinore. Politika, zhvillimi politik dhe tema e integritetit në BE janë çështje me rëndësi por edhe delikatesë të veçantë në vend, për shkak se flitet për tema të cilat konsiderohen gjerësisht si çështje për "të rriturit", gjë e cila ka kontribuar në dekurajimin e pjesëmarrjes dhe të kuptuarit tek të rinjtë mbi diskursin politik.

"Debato si një Evropian" shënoi bashkëpunimin e dytë të rëndësishëm midis H.A.N.A dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Dukatit të Madh të Luksemburgut në vitin 2021. Duke ndërtuar mbi suksesin e nismës së parë, "Hyrje në Politikëbërje dhe Integritetin Evropian", ky projekt i ri synonte të zgjeronte arritjet dhe ndikimin e edukimit politik për të rinjtë në Lezhë. Nisur në fillim të shtatorit 2021, kjo ndërhjyre përfaqësonte një zgjerim të nismës fillestare, duke e shtrirë atë në tetë shkolla të ndryshme në Lezhë. Ndryshe nga shkolla dimërore, e cila ftonte të rinjtë në qendrën H.A.N.A, kjo nismë solli edukimin joformal drejtpërdrejt në shkolla, duke siguruar akses për nxënës që ndryshe nuk do të mund të merrnin pjesë për shkak të sfidave logjistike.


Kjo nismë adresoi një hendek kritik në sistemin arsimor të Shqipërisë, ku mësimi joformal tradicionalisht nuk integrohet në kurrikulat shkollore, veçanërisht në rajone si Lezha. Duke zgjeruar arritjet e saj në shumë shkolla, H.A.N.A synoi të ofronte mundësi për angazhimin politik dhe qytetar për nxënës që zakonisht kanë akses të kufizuar në aktivitete të tilla. Projekti ishte veçanërisht me ndikim duke pasur parasysh mungesën e universiteteve dhe politikave miqësore ndaj punësimit të të rinjve në Lezhë, të cilat kontribuojnë në nivele të larta të emigrimit të të rinjve. Përpjekjet e H.A.N.A ofruan një mundësi unike për të rinjtë e



moshës 14-19 vjeç në Lezhë për tu angazhuar në përvoja të të nxënimit me kuptim, që nxisin mendimin kritik dhe ndërgjegjësimin qytetar. Programi gjithashtu u mentorua nga ekspertë dhe figura të njohura në sferat politike dhe shoqërore shqiptare dhe përshiu vizita studimore në misione kyçe diplomatike, si Delegacioni i BE, ambasadat suedeze, austriake dhe të SHBA-ve, si dhe takime me diplomatë të njohur, përfshirë Ambasadorin e Luksemburgut për Ballkanin Perëndimor Z. Philippe Donckle.

Përfshirja e H.A.N.A në monitorimin e zgjedhjeve përfaqëson një moment tjetër të rëndësishëm në misionin e saj për të fuqizuar komunitetin dhe për të mbrojtur parimet demokratike. Në vitin 2021, H.A.N.A bashkëpunoi me KRIIK Albania për të monitoruar aktivisht zgjedhjet parlamentare në qarkun e Lezhës, duke shënjuar kështu edhe eksperiencën e saj të parë në monitorimin zgjedhor. Kjo nismë mori një vëmendje të konsiderueshme nga qendra gjatë vitit 2021, duke reflektuar angazhimin e saj për të siguruar zgjedhje të lira dhe të ndershme në një rajon (Qarku Lezhë) që shpesh neglizhohet nga organizatat më të mëdha kombëtare në shtrirjen e tyre operacionale. Përpjekjet e monitorimit ofruan një pasqyrë të rëndësishme mbi integritetin zgjedhor, angazhimin e votuesve dhe sfidat me të cilat përballen komunitetet lokale gjatë procesit zgjedhor. Kjo përvojë jo vetëm forcoi kapacitetin e H.A.N.A për të kontribuar në demokracinë lokale, por gjithashtu pozicionoi organizatën si një zë të besueshëm në advokimin për transparencën zgjedhore në Lezhë.

Më tej, H.A.N.A eksploroj një aspekt të ri të aktivizmit civil; atë përmes performancave teatrale që adresojnë çështje të barazisë gjinore. Në bashkëpunim me dramaturgun Vladimir Doda dhe shkollën jo-publike "Lezha Academic Center" në Lezhë, sollëm një performancë teatrore unike për publikun e Lezhës. Për herë të parë, tetë vajza të reja dolën në skenë si aktore amatore, duke prezantuar performancën me titull "Riedukimi i Apolonit", një dramë e frymëzuar nga narrativa mitologjike e femicidit të parë të regjistruar në mitologjinë greke. Drama inkurajoi aktoret e reja dhe audiencën të reflektonin mbi ndikimin e vazhdueshëm të dominimit patriarkal dhe mentalitetit përjashtues me të cilin përballen vajzat dhe gratë shqiptare. Miti, me rrënjët e tij në të kaluarën tonë të largët, shërbeu si themel për këtë projekt. Mitet shpesh mbartin urtësi në vetvete për mënyrën si kontribuojnë në jetën e njeriut, por gjithashtu mund të përmbajnë besime arkaike që duhet të sfidohen, si në rastin në fjalë. Përmes kësaj drame, H.A.N.A synoi të analizonte, rishtjellonte dhe madje të parodizonte mitin për të promovuar evolucionin shoqëror. Performanca simbolikisht adresoi çështje që lidhen me rolin e gruas, duke përdorur mitin për të krijuar një dramaturgji fragmentare që lejoi aktoret e reja të eksploronin dhe të kuptonin veten përmes perspektivave të tyre.




Në vitin 2021, H.A.N.A bëri gjithashtu hapa të rëndësishëm në advokimin mjedisor dhe angazhimin komunitar përmes nismave të drejtuara nga të rinjtë. Në bashkëpunim me Leviz Albania, nisëm projektin "Rini, Riciklim, Respekt – Ekosistemi i Dashurisë Mjedisin", duke u fokusuar në përdorimin e përgjegjshëm të plastikës dhe diferencimin e mbetjeve në Lezhë. Duke angazhuar mbi 250 të rinj pjesëmarrës, përfshirë 145 drejtpërdrejt në aktivitete e punëtori praktike, ne prezantuam dhe zbatuam një model funksional të diferencimit të mbetjeve, i cili parashikonte një bashkëpunim me Bashkinë e Lezhës për një program pilot të diferencimit të mbetjeve në një lagje të Lezhës (Rr. "Luigj Gurakuqi", qytet). Gjithashtu organizuam fushata ndërgjegjësimi, punëtori (workshops) për riciklim kreativ dhe madje një ekspozitë arti me materiale të ricikluara për të nxjerrë në pah çështjet mjedisore. Pavarësisht sfidave në bashkëpunimin me autoritetet lokale, të cilat nuk e pane plotësisht vlerën e pilotimit duke peshuar më shumë "andrallat" burokratike të zbatimit të saj në trajtë më të shtrirë, H.A.N.A mbetet e angazhuar për të advokuar për praktika të qëndrueshme të menaxhimit të mbetjeve, duke siguruar që të rinjtë lokalë të luajnë një rol aktiv në formësimin e së ardhmes mjedisore të komunitetit të tyre.

Gjatë muajve të verës, aktivitetet e H.A.N.A u zhvendosën disi për të përfshirë një angazhim më të gjerë me institucionet publike dhe jo-publike në Lezhë. Një zhvillim kyç ishte bashkëpunimi i vijueshëm i organizatës me institucionet arsimore vendore, si Gjimnazi "Hydajet Lezha" për plotësimin e orëve të shërbimit komunitar duke u angazhuar në projekte të ndryshme të udhëhequra nga qendra rinore. Ky bashkëpunim përforcoi kredibilitetin e H.A.N.A si një ofrues shërbimesh për të rinjtë dhe aktivitetesh për angazhim komunitar, veçanërisht në fushat e pasurimit shoqëror dhe kulturor.

Gjithashtu, H.A.N.A pilotoi sërish klubin rinor "Bëhu Burrë", një program i fokusuar në adresimin e dhunës me bazë gjinore dhe sfidimin e normave të dëmshme gjinore. Ndërsa projekti fillimisht përballi sfida në rekrutimin e pjesëmarrësve meshkuj, u arrit që deri në mesin e vitit 2021, pjesëmarrja e tyre (djemve) të kapte vlerat 30%. Kjo ishte një arritje e rëndësishme në sfidimin e normave patriarkale të ngulitura që shpesh kufizojnë përfshirjen e djemve dhe burrave në nisma shoqërore dhe kulturore, veçanërisht ato që promovojnë barazinë gjinore.

Deri në fund të vitit, fokusi programatik i H.A.N.A mbeti në katër shtylla kryesore: Edukimi Mediatik, Demokracia dhe Vendimarrja Publike, Barazia Gjinore dhe Edukimi Mjedisor.

Zbatimi i këtyre shtyllave strategjike i lejoi H.A.N.A të organizonte një varietet aktivitetesh, duke përfshirë mentorime, takime komunitare, nisma të angazhimit qytetar dhe më shumë. U formuan partneritete të rëndësishme, duke përfshirë marrëveshje me Faktaje.al dhe Qendrën për Gazetari Cilësorë për të krijuar klube të edukimit mediatik për të rinjtë.



Pavarësisht sfidave të burimeve buxhetore, veçanërisht drejt pjesës së fundit të vitit me përfundimin e mbështetjes financiare nga EED, H.A.N.A ruajti vrullin e saj. U kërkuan financime alternative dhe u ruajt fort vëmëndja në qëndrueshmërinë e qendrës duke ndërtuar partneritete të forta dhe duke vazhduar të shërbejmë si një hapësirë mikpritëse për të rinjtë. Pavarësisht se u përballëm me pengesa të konsiderueshme në sigurimin e financimeve shtesë afatgjata, sërish, H.A.N.A mbeti e qëndrueshme, duke vazhduar të advokojë për misionin e saj dhe të shërbejë si një platformë për angazhim qytetar në Lezhë.

Viti 2021 u përmbyll dhe e gjeti qendrën në një fazë pjekurie në pozicionimin e saj brenda sektorit të shoqërisë civile të Shqipërisë. E njohur për angazhimin e saj proaktiv me të rinjtë, H.A.N.A kishte zhvilluar një reputacion të denjë për ofrimin e shërbimeve unike dhe me kuptim për të rinjtë në Lezhë, të cilët shpesh kanë mundësi të kufizuara për pjesëmarrje qytetare.


2022: Konsolidimi i Ndikimit dhe Ndërtimi i Partneriteteve

Viti 2022 ishte një periudhë si sfidash ashtu edhe rritjeje për Qendrën H.A.N.A., ndërsa lundruam kompleksitetet e ruajtjes dhe zgjerimit të aktiviteteve tona mes vështirësive ekonomike dhe gjeopolitike. Viti filloi pa mbështetje programatike, duke e lënë H.A.N.A të mbështetej në menaxhimin kreativ të burimeve dhe projektet në vazhdim për të vijuar misionin tonë.

Gjysmën e parë të vitit 2022 e kaluam duke vijuar punën me një periudhë të zgjatur 3-mujore (Janar – Mars '22) të zbatimit të projektit "Rini, Riciklim, Respekt - Ekosistemi i Dashurisë për Mjedisin", i financuar nga Leviz Albania, i cili duhej të përfundonte në Dhjetor të 2021. Ky projekt u fokusua në advokimin mjedisor dhe menaxhimin e përgjegjshëm të mbetjeve, duke vënë theksin tek angazhimi rinor. Përmes këtij zgjerimi, H.A.N.A arriti të mbulonte orët e shërbimit komunitar në partneritet me Gjimnazin Hydajet Lezha, duke angazhuar me sukses nxënësit në aktivitete praktike që promovonin ndërgjegjësimin mjedisor dhe përgjegjësinë ndaj komunitetit.

Gjatë kësaj faze sfiduese të fillimit, H.A.N.A gjithashtu punoi për të çuar përpara 2 partnerite të vlefshme të ngritura që në vitin paraardhës (organizatat mediatike —Faktoje dhe Qendrën Shqiptare për Gazetari Cilësore). Këto bashkëpunime kishin për qëllim krijimin e klubeve të edukimit mediatik për të rinjtë, duke fuqizuar të rinjtë të eksploronin fuqinë e medias dhe gazetarisë si mjete për promovimin e transparencës, llogaridhënies dhe angazhimit të informuar qytetar.

Gjithashtu, një moment me rëndësi ishte bashkëpunimi i ri me Ambasadën Suedeze në Shqipëri për të sjellë në Lezhë ekspozitën inovatore të konceptuar nga Instituti Suedezi – “Re:Waste – Si po i Ri-koncepton Suedia Mbetjet” me fokus promovimin e modelit Suedezi të



menaxhimit të mbetjeve në Lezhë, ndërhyrje që kulmoi me një inaugurim masiv me prezencën e vetë Ambasadores së Suedisë në Shqipëri, Znj. Elsa Hastaad, Ministres së Turizmit si dhe Kryetarit të Bashkisë Lezhë, e një numri të madh përfaqësuesish vendor dhe banorësh e të rinjsh të Lezhës. Të gjithë së bashku për një angazhim të rinovuar për manaxhimin e mbetjeve në Lezhë.


Ritheksojmë sërish arritjen e bashkëpunimit të H.A.N.A me Ambasadën Suedeze në Shqipëri, që e pozicionoi qendrën rinore si një qendër për diskutime domethënëse mbi menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë vendimmarrës kyç në nivel vendor dhe qendror në këto diskutime. Ky partneritet i lejoi H.A.N.A të luante një rol vendimtar në sjelljen së bashku të aktorëve lokalë dhe qendrorë për të adresuar çështjet e ngutshme mjedisore në Lezhë. Përpjekjet avokuese të qendrës për promovimin e praktikave të qëndrueshme të menaxhimit të mbetjeve u pritën mirë nga komuniteti dhe ndihmuan në forcimin e rolit të H.A.N.A si një aktor kyç në aktivizmin mjedisor në rajon.

Këto përpjekje jo vetëm siguruan vazhdimësinë e ndikimit të H.A.N.A, por gjithashtu vendosën themelet për rritje dhe qëndrueshmëri në të ardhmen.

